



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 12

Datë: 12. 05. 2017, ora: 09:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Bajram Ljafiti, Ercan Spat, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

2. Aktivitetet e ZRPP-së

- *Shqyrtim i rekomandimit për regjistrim të Iniciativës Politike “Lëvizja VETËVENDOSJE!*
- *Shqyrtim i rekomandimit për iniciativën politike “GRADANSKA INICIJATIVA SRPSKA LISTA-GiSL”*
- *Shqyrtim i rekomandimit për iniciativën politike “SRPSKA LISTA-SL”*

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së

4. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: ...Ne, kemi komunikuar...Sot është afati i fundit për akreditim të vëzhguesve...Propozoj që, shqyrtimi i zgjatjes së orarit të bëhet pika e parë, dhe mandej të vazhdojmë me pikat e tjera. A ka dikush tjetër...?

Ilir Gashi: Në mbledhje të këshillit të buxhetit, e kemi trajtuar një shkresë që ka ardhur nga një grup parlamentar. Rekomandimi i këshillit është se, ajo shkresë të trajtohet si për të gjitha grupet parlamentare. Mbasi që veç ua kemi ndarë mjetet, grupet parlamentare të kenë të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve deri në certifikim të rezultateve, ashtu siç e kemi bërë edhe në zgjedhjet e kalueme. Pra, kjo të jetë pikë e veçantë...

Betim Gjoshi: Renditja e subjekteve të bëhet qysh ka qenë në rekomandim të zyrës, dhe siç është në draftvendime...! Renditja, bëhet sipas kohës që kanë aplikuar subjektet... (Nuk dëgjohet mirë incizimi...)

Ercan Spat: Të plotësohet materiali...Kam mangut material, dhe e kam vështirë si të veprojë...Një iniciativë e ka vendimin, një tjetër se ka...!

Miradije Mavriqi: Do të përgatiten të gjitha, në ndërkohë...

Valdete Daka: I kemi edhe këto propozime...? Kush është për rendin e ditës, me këto plotësime...

Anëtarët e KQZ-së, në mënyrë unanime, miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Fillojmë nga pika e tretë...

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së

Enis Halimi: Për ti kryer punët në mënyrë efikase në këtë kohë, ne jemi të detyruar që të marrim vendim për zgjatjen e afatit për punët e stafit, varësisht nga dinamika, ndonjëherë edhe përtej...Pra, në të kaluarën kjo është bërë me një udhëzim formal, e kësaj here edhe kjo çështje ka dalë në mbledhje...

Bajram Ljatifi: Jemi në fazën e gjendjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Kemi praktikë se si duhet punuar...KQZ, duhet të jetë në gjendje gatishmërie njëzetë e katër orë. Anëtari i KQZ-së, në momentin që kërkohet, ai sapo të lajmërohet për dy orë duhet në jetë në KQZ. Ky, është qëndrimi si kemi punuar...

Valdete Daka: Asgjë nuk ka ndryshuar...

Betim Gjoshi: Gjatë ditëve kur ka afate që përfundojnë, sektori përkatës duhet të punojë deri në ora 24, sepse e kemi certifikimin e partive, shërbimin votues kur është fjala për votimin me jashtë...Afatet ligjore duhet respektuar, sidomos kur ato zgjasin njëzetë e katër orë, edhe ditëve të vikendit...

Valdete Daka: Vërejtjet, le të plotësohen në draftvendim...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan propozimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së

3. Vëzhgimi i Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kroacisë

Valdete Daka: Ne kemi marrë një vendim që t'i vëzhgojmë zgjedhjet në Kroaci, të cilat mbahen me 21 maj, por situata ka ndryshuar dhe nuk mund të shkojmë në numrin e paraparë. Por, a mundem me shkaur një, apo dy persona është çështje që do ta shqyrtojmë...

Sami Hamiti: Me qenë e përfaqësuar KQZ-ja, është mirë, dhe dikush prej Sekretariatit...Unë, propozojë që dy anëtarë të shkojnë nga KQZ, dhe një nga sekretariati...Edhe katër nuk është shumë, sepse është mirë me u përfaqësue...

Valdete Daka: Kontaktoni, sepse ka ndryshue situata. Mirë...kush është tre anëtar nga KQZ, dhe një nga Sekretariati të shkojnë t'i vëzhgojnë zgjedhjet...?

Binak Vishaj: Kemi marrë vendim...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimin me ndryshme për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale në Kroaci.

Ilir Gashi: Atë që e kemi bërë në zgjedhjet e kaluara, si kërkesë e grupeve parlamentare që ato të jenë në funksionim deri në certifikim, të jetë në funksion kryesia e Kuvendit sepse ajo nuk mund të mblidhet pa funksionimin e grupeve parlamentare, administrata etj. Ne, mjetet ua kemi lejuar, dhe ato vetmë duhet lejuar...

Betim Gjoshi: Ia kemi ndarë një gjobë Nismes dhe, pagesa bëhet me rata deri në fund të vitit...Kurse, zgjedhet prodhojnë tjetër efekt...Për mos me pasë problem në zgjedhje, në certifikim të gjendet mënyra që ky borgj të hiqet...

Valdete Daka: Kujdesuni...

4. Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrtim i rekomandimit për iniciativën politike "GRAĐANSKA INICIJATIVA SRPSKA LISTA-GiSL"

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP-së. Zyra, ka dërguar për rekomandim iniciativën politike "GRAĐANSKA INICIJATIVA SRPSKA LISTA-GiSL". E para, ka aplikuar për regjistrim, më 4 prill të këtij viti. Kryesues i listës, është Slavko Simiq. Është kontrolluar dokumentacioni, dhe se zyra ka vërejtur që statusi dhe programi nuk kanë qenë në përputhje me ligjin...

Janë bërë plotësimet, janë përmirësuar vërejtjet dhe zyra në bashkëpunim me këtë subjekt, parti...për çdo çështje të kontestueshme apo që nuk ka qenë në përputhje me ligjin dhe rregullativën në fuqi, ka ndërmarrë masat...Janë plotësuar kushtet, mirëpo janë disa vërejte...Zyra, e ka një sugjerim që ky subjekt ta plotësojë dhe ta ndryshojë statutin konform nenit 14 të rregullës, brenda gjashtë muajve kur edhe është e obliguar që ta mbajë kuvendin e parë...

Ndërsa, ky subjekt hynë në regjistrin e partive politike me numrin rendor: 57.

Betim Gjoshi: Ne, jemi në një periudhë zgjedhore, ndoshta këto subjekte kanë aplikuar përpara se m'u shpallë zgjedhjet...Nuk po paragjykoj asgjë, por në kushtet normale këto subjekte kanë të meta në statut, në program politik...

Do të votoj për, tha z. Gjoshi, mirëpo, ne, asnjëherë nuk duhet që të mos krijojmë kushtet të barabarta për të garuar...Unë do të votoj për...por, zyrës, i mbetet vazhdimisht ti përcjellje partitë politike...Ne, edhe nëse e regjistrujmë një parti, ne duhet me e përcjellë çdo ndryshim... Për ne, programi politik është më pak i rëndësishëm...Për ne, është i rëndësishëm statuti dhe mënyra e rregullimit. Funkcionimi i partive, është me rëndësi . Ka parti me të cilat kemi pasur problem, sepse ka vendosur me 3/4 në mënyrë, jo demokratike...Në realitet, është e pamundur me funksionuar...

Nuk kemi kohë sepse jemi në proces, përndryshe unë do të votoja kundër...sepse, njëra prej këtyre subjektet ka dispozita që janë edhe në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet, tha z. Gjoshi. Aty, thuhet gjëra, si: "Ja merr mandatin, ja ndërpre në mandatin, e tërheqë...bënë xhirollogari...hapë degë, thotë hapë parti lokale...etj."

Nuk po dua të përmend emra, por në kushte normale s'do të kisha dashur as me diskutuar...mirëpo, do të votoj për...

Nenad Rikallo: Iniciativa Serpska Lista, ka marrë pjesë në punën parlamentare 2014, deri dje kur u shpërbë parlamenti...Si edhe të tjerët, kanë marrë vendim për t'u regjistruar, edhe pse ligji nuk e ka definuar që kjo është obligim...

Është diskutuar në lidhje me këtë problem, tha z. Rikallo. Ne, kemi ardhur në situatë të re: janë dy kërkesa, dy aplikime se kush do të udhëheqë këtë subjekt...Kam kërkuar që të diskutohet në këtë drejtim, e nuk është diskutuar...Tash, kemi ardhur në një gjendje ku nuk ka më kohë dhe, duhet vepruar shpejtë...Me regjistrimin e këtij subjekti, kemi pasur kujdes që të respektohen rregulloret dhe ligji...Zyra, ka kthyer disa vërejtje, mirëpo 98% të normave janë respektuar...Neni 1.1, dhe jo neni 14 me të cilin thirret zyra...jo, është një pjesë e nenit që ne mendojmë se të gjithë ata që janë kuvendar dhe të certifikuar si kandidatë, anëtarë të qeverisë janë në këtë subjekt...Jemi konsultuar me juristët, dhe kemi bindjen se nëse KQZ thotë se ne jemi në kundërshtim me ligjin, ne mendojmë që nuk jemi...Por, sugjerimet e zyrës, do t'i respektojmë...sado që mendojmë se nuk jemi në kundërshtim me ligjin...

Adnan Rustemi: Pa dashur me zgjatë debatin, asdo që është një temë që do duhet analizuar gjerësisht...Sepse, kjo fusha e funksionimit të partive politike është një fushë e hulumtuar deri në nivele

akademike, profesionale, të organizatave ndërkombëtare... etj. Kam përcjellë funksionimin e partive, raportet e organizatave, të Komisionit të Venecias, të Këshillit të Evropës etj..

Tri çështje, do doja t'i bëja me dije: E para, se KQZ nuk ua miraton statutet partive politike. Ne, nuk miratojmë statuet, sepse ato janë dokumente të brendshme të partive...Mënyra qysh ne po i trajtojmë statutet, nënkuptohet kështu sikur ne ua miratojmë...Për mua, tha z. Rustemi, zyra duhet të sigurohet që statuti, i përmbanë të gjitha aspektet që rregulla i kërkon për organizimin dhe funksionimin e një partie... Pra, ne nuk e shikojmë çdo germë, çdo fjalë...Unë, tha ai, për nenin kontestues që e ka kjo iniciativë mund të mos pajtohem, mund të pajtohem, mund të mos e kem të aqhtë, mund ta kemë...etj., mirëpo, kjo nuk prodhon asnjë efekt juridik... E dyta: cili është roli juridik i KQZ në regjistrimin e partive politike...? Këtë, e tha z. Betimi, por nëse e shohim ligjin, regjistrimi duhet të bëhet me konsensus, dhe vetëm kur s'mundet fare, me 2/3. Por, ishte dashur të shterreshin të gjitha shqyrtimet, sado që ka edhe të tjera instanca. Ligji, edhe s'jep shumë hapësirë...Unë, jam për, sado që nuk pajtohem me aspektin politik, por juridikisht nuk e kundërshtoj...

Binak Vishaj: Që prej kur jam anëtar, ne rekomandimet e zyes i kemi votuar unanimish. Sado që u thanë shumë çështje, dhe pajtohem por, ne kemi nevojë të sigurohemi që vërejtjet tona këto subjekte në kuvendet e tyre, do ti plotësojnë...Duhet të informohet KQZ, në të ardhmen se, a janë plotësuar sugjerimet...

Betim Gjoshi: Po, ne nuk i miratojmë statutet, por i regjistrojmë në bazë të statuteve...Të procedojmë sot, e pastaj...

Valdete Daka: Kush është për regjistrimin e kësaj iniciative...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP-së për regjistrimin e iniciativës politike "GRAĐANSKA INICIJATIVA SRPSKA LISTA-GiSL", me numër rendor 57, me një votë apstenimi (Valdete Daka)

Shqyrtim i rekomandimit për iniciativën politike "SRPSKA LISTA-SL"

Miradije Mavriqi: Në të njejtën ditë, më 4 prill 2017, ka aplikuar për regjistrim edhe një nismë politike. Zyra, ka kontrolluar aplikacionin. Dhjetë ditë kanë pasur afat për t'i bërë ndryshimet eventuale, si dhe vërejtjet tona. Çdo gjë është bërë sipas proceduarave të duhura. Nuk kemi pasur ndonjë ankesë, iniciativa i ka plotësuar kushtet dhe ne rekomandojmë për regjistrim.

Betim Gjoshi: Është në rregull rekomandimi, por ka një çështje: neni 5.1, subjektet me emër të ngjashëm nuk mund të regjistrohen dhe në vazhden e kësaj, unë kisha kërkuar shpjegim. Ndoshta, është mirë që shihet puna e emrit...

Miradije Mavriqi: E kemi shqyrtuar, por kemi marrë edhe praktikat e tjera. Kemi parti me të njëjtin emër, si për shembull Balli Kombëtar...Por kam bërë krahasime, simbolet ndryshojnë, dhe ne mendojmë se është në rregull...

Nenad Rikallo: Jo vetëm neni 5, por edhe neni 21...Këtu, bëhet fjalë për emër të njejtë, pra me ngjashmëri të plotë...Dhe, mendoj se emri i njejtë nuk mund të përdoret...! Sepse, shkakton huti, dhe jo vetëm kjo...Pra, ai emër nuk mund të përdoret. Ka nene të statutit që janë në kundërshtim me rregullat dhe ligjet e Kosovës: 2 nene të statutit janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, dhe 4 nene të tjera janë në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet...

P.s. Para anëtarëve të KQZ-së, Nenad Rikallo, bëri një elaborim të gjerë lidhur me statutin e kësaj iniciative, dhe shpjegoi se çka dhe si, është në kundërshtim me rregullat dhe me ligjet në fuqi..)

Binak Vishaj: Ato që kisha ndërmend t'i them, u konsumuam. Nuk kam diçka të veçantë, do ta mbështesë rekomandimin e zyrës...

Eshref Vishi: Zyra, a i ka shqyrtuar shqetësimet që i ngriti kolega...

Betim Gjoshi: Ato që i tha z. Rikalon për statutin, qëndrojnë...Por, unë them që të shihet neni 21 i ligjit: emri, është i ngjashëm...Sepse, unë s'do të lejoja që një iniciativë të regjistrohet me emrin "Partia Demokratike e Kosovës" në asnjë variant sepse, ne po e rregjistromë...

Adnan Rrustemi: Jo, për mua është shqetësues faktin se si ka mundësi që për çështjet që janë bash thelbësore të zyrës, të KQZ-së, kemi njëfarë kapërcim me lehtësi...s'ka një analizë më të thellë, ndërsa për çështjet që komplet s'kanë të bëjnë me zyrën apo KQZ-së, kemi vlerësime apo rekomandime të kushtëzueme...

Për mua, tha z. Rrustemi, janë tri përgjegjësi kryesore që rrjedhin nga ligji lidhur me regjistrimin e partive politike: Emri identik ose i ngjashëm që krijon konfuzitet te votuesi. Unë, në fakt, e pyeta z. Nenadi se, cili është subjekti juaj...? Pra, ky është roli i zyrës: qysh, si ndikon...? E dyta: simboli, dhe janë çështjet e tjera të parimeve dhe demokracisë së brendshme...

Nga zyra, në të kundërtën, kemi rekomandim të plotë për regjistrim, por... këtë mundet me na e kthyer mbrapsht PZAP...

Ilir Gashi: Sa i përketë precedanit, ne është mirë me vendos secili më vete se, a mund ta pranojmë një iniciativë qytetare me emër të njejtë...Unë, konsideroj që këtu bëhet fjalë për emër të njëjtë, dhe ne duhet dhënë 24 orë afat për ndryshime...Për çështje të tjera statutare, nuk do të ndalem por kur është fjala për emrin, unë s'bëjë asnjë kompromis...Kemi pasur raste, siç ka qenë rasti me LDD-në etj.

Adnan Rrustemi: Veç një fjalë: KQZ, nuk është instanca e fundit...Pra, ka mundësi për t'u ankuar por...

Valdete Daka: Ka një koncensus që kësaj iniciative, t'i jepen 24 orë për përmirësime...

Adnan Rrustemi: Tash, ishte dashur të ishim për apo kundër, sepse proceduralisht nuk është në rregull...

Sami Hamiti: Po, ka precedane...LDK në raport me PDK, Balli Kombëtar me Ballin Demokrat, pra ka sinonime, s'ka çka...

Eshref Vishi: Ëshët shteruar debati...

Betim Gjoshi: Veç emrit, edhe simboli nuk është në rregull...

Valdete Daka: Kush është që kësaj iniciative t'i jepen 24 orë t'i bëjë përmirësimet...?

Anëtarët e KQZ-së, me dy vota kundër, nuk e miratuan rekomandimin e ZRPP-së.

Shqyrtim i rekomandimit për regjistrim të Iniciativës Politike "Lëvizja VETËVENDOSJE!"

Miradije Mavriqi: Me 14 prill 2017, ka aplikuar edhe iniciativa Politike "Lëvizja VETËVENDOSJE!", e kryesuar nga z. Visar Ymeri. Zyra, ka vepruar sipas afatit, ka dhënë sugjerimet e veta dhe në afat ligjor janë bërë shpalljet publike...Nuk kemi pasur ankesa...Zyra, në afat prej gjashtë muaj nga regjistrimi, ka dhënë sugjerimet që kjo iniciativë ta plotësojë nenin 1 të statutit. Konsiderojmë se, në afat prej 6 muaj të bëhen përmirësimet, dhe se ne rekomandojmë që kjo iniciativë të regjistrohet në regjistrin e parive politike me nr. 59.

Adnan Rustemi: Për korrektësi, kam dëshirë të diskutojmë...por, nuk do të ndalem...Po them diçka: nga të gjitha sugjerimet, dy ndryshime janë kërkuar: mosha e anëtarësimit, por të tjerat kanë qenë kërkesa që nuk parashihen në rregullore, por që ne i kemi plotësuar...Për shembull, kuotën e pagesës së anëtarësisë, përshkrimin e vulës, të logos etj., por që nuk janë në rregullat e KQZ-së, nuk kërkohen... Unë, tha z. Rustemi, e pranojë rekomandimin por, jo edhe kushtëzimin...!

Nenad Rikallo: Ne, kemi probleme me funksionimin e Zyrës së Partive Politike. Unë, jam ballafaquar me shumë probleme, nuk kam mundur t'i marrë materialet e duhura, raportet...dhe, mendoj se zyra nuk ka transparencë të duhur lidhur me punën që bëjnë...

Adnan Rustemi: Kërkoj të procedohet, e pastaj flasim...

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, anëtarët miratuan rekomandimin e zyrës për regjistrimin e Iniciativës Politike "Lëvizja VETËVENDOSJE!" me numër rendor 58, me një votë abstenimi (Valdete Daka).

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare

